

Inovacion, media, mendje: mbështetje për gazetarinë në funksion të shërbimit publik**Duration:** 01.09.2023 - 31.08.2026**Countries:**

Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Shqipëria

Total budget: € 3 300 000**Implementer:**

DW Akademie

**Website(s):** goethe.de/ins/gr/de/kul/eup/imm.html**Project description:**

Projekti "Inovacion, media, mendje" (IMM) mbështet transmetuesit e shërbimit publik në Ballkanin Perëndimor në përmirësimin e cilësisë së përmbajtjes, modernizimin e rrjedhave të punës dhe forcimin e angazhimit të publikut. IMM ndihmon mediat e shërbimit publik (PSM) t'i shërbejnë më mirë audiencës së tyre, duke përmirësuar praktikën e menaxhimit, strukturat e brendshme dhe duke u përshtatur me një peizazh digjital në ndryshim të vazhdueshëm. Qëllimi qendror është promovimi i gazetarisë së pavarur dhe me cilësi të lartë, e cila pasqyron nevojat e komuniteteve të ndryshme.

Profesionistët mediatikë, nga gazetarët dhe redaktorët deri te stafi teknik, përfitojnë nga trajnime të synuara, grante dhe mundësi për bashkëpunim rajonal. Vëmendje e veçantë i kushtohet fuqizimit të gazetarëve, trajnerëve dhe krijuesve të rinj të përmbajtjes për të nxitur inovacionin dhe për të mbështetur standardet profesionale.

Përmes investimeve strategjike në ndërtimin e kapaciteteve, projekti mbështet iniciativë që rrisin rëndësinë, qasshmërinë dhe besimin e publikut në përmbajtjen mediatike. Bashkëpunimet dhe bashkëprodhimet ndërkufitare nxisin në mënyrë aktive forcimin e lidhjeve midis transmetuesve dhe promovojnë të nxënëit e përbashkët. Duke ofruar fonde, trajnime dhe rrjetëzim, IMM ndihmon në ndërtimin e një peizazhi mediatik publik më elastik, gjithëpërfshirës dhe me vizion në rajon.

Expected results:

Deri në fund të projektit, mediet në shërbim të publikut në të gjithë Ballkanin Perëndimor pritet të paraqesin:

- Aftësi më të forta menaxhimi dhe rrjedha pune të brendshme më frytdhëdhënëse;
- Struktura editoriale të përmirësuara dhe procese prodhimi të modernizuara;
- Programe me cilësi më të lartë që i shërbejnë më mirë interesit publik;
- Aftësi të përmirësuara të profesionistëve mediatikë, veçanërisht të gazetarëve dhe trajnerëve të rinj;
- Përdorimi i rritur i mjeteve dhe teknikave inovative në gazetari;
- Përfshirje më e madhe e publikut në krijimin e përmbajtjes dhe informata kthyes;
- Një brez i ri shumëzuesish që mbështesin gazetarinë cilësore;
- Standarde më të forta etike dhe profesionale në të gjithë transmetuesit publikë;
- Bashkëpunim i zgjeruar midis mediave të shërbimit publik në rajon;
- Më shumë bashkëprodhime ndërkufitare dhe projekte mediatike të përbashkëta;
- Rrjet mediatik publik më të fortë dhe më të lidhur në Ballkanin Perëndimor;